

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. KOL 207
NR. REP 111



MARRËVESHJE PENGU DHE/OSE BARRË SIGURUESE

Sot, më 26.01.2005, në Tiranë, përpara meje Znj. Mimoza Sadushi, Notere Publike e Dhomës së Notereve Tiranë u paraqitën përfaqësuesit e palëve të mëposhtme:

- (1) **FUSHE KRUJA CEMENT FACTORY Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Fabrika e Cimentos, Fushe Kruja, Shqipëri, e përfaqësuar nga Z. Sadi Dahdale, në cilësinë e tij si përfaqësues ligjor (më poshtë referuar si, "Shoqëria"); dhe
- (2) **SIJAMENT HOLDING S.A.L.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Libanit, me seli në Rabieh, First Avenue, Vila 48, Antelias, Liban, e përfaqësuar nga Z. Jacques Sehnaoui, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor (si më poshtë, "Pëngdhënesi"); dhe
- (3) **INTERNATIONAL FINANCE CORPORATION**, një organizatë ndërkombëtare me seli në 2121 Pennsylvania Avenue N.W., Washington, D.C. 20433, SH.B.A., përfaqësuar nga Znj. Elira Sakiqi, në cilësinë e saj si përfaqësuese e autorizuar në bazë të prokurës që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshje (si më poshtë, "IFC"); dhe
- (4) **EUROPEAN BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT**, një organizatë ndërkombëtare me seli në One Exchange Square, London EC2A 2JN, Londër, Angli, përfaqësuar nga Z. Murat Yildiran, në cilësinë e tij si përfaqësues i autorizuar në bazë të prokurës që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshje (si më poshtë, "EBRD"); dhe
- (5) **ALPHA BANK A.E., DEGA E TIRANËS**, një degë bankare e krijuar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, me seli pranë Bulevardi Zog I nr. 47, Tirana, Shqipëri, degë e bankës Greke Alpha Bank A.E., përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjorë Z. Andreas Galatoulas dhe Z. Orfea Dhuci, që veprojnë bashkërisht, (si më poshtë, "Alpha Bank"); dhe
- (6) **OPEC FUND FOR INTERNATIONAL DEVELOPMENT**, një organizatë ndërkombëtare me seli në Parkring nr. 8, A-1010 Vjenë, Austri, përfaqësuar nga Znj. Klodilda Ferhati në cilësinë e saj si përfaqësuese e autorizuar në bazë të prokurës që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshje (si më poshtë, "Fondi OPEC").

Unë, Noteri, pasi studiova dokumentacionin e paraqitur nga Palët apo përfaqësuesit e tyre, vërtetoj se personat që përfaqësojnë Palët janë madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar dhe se personat juridikë të paraqitur janë themeluar në mënyrë të rregullt. Me vullnetin e tyre të lirë, Palët kanë kërkuar dhe kanë rënë dakort të përgatisin këtë Marrëveshje Pengu dhe/ose Barrë Siguruese në përputhje me dispozitat ligjore të Republikës së Shqipërisë dhe sipas rregullave dhe kushteve të mëposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE:

- (A) Nëpërmjet një kontrate kredie me datë 10.9.2004, EBRD ka rënë dakort, *inter alia*, ti japë Fushë Kruja Cement Factory Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë (si më poshtë, "FKCF"), një kredi që i korrespondon shumës maksimale prej US\$ 30,000,000 (tridhjetë milionë Dollarë SH.B.A.), në përputhje me dhe sipas kushteve të asaj kontrate.
- (B) Nëpërmjet një kontrate kredie me datë 10.9.2004, IFC ka rënë dakort, *inter alia*, t'i japë FKCF një kredi që i korrespondon shumës maksimale prej US\$ 30,000,000 (tridhjetë milionë Dollarë SH.B.A.), në përputhje me dhe sipas kushteve të asaj kontrate.
- (C) Nëpërmjet një kontrate kredie me datë 21.9.2004, Alpha Bank ka rënë dakort, *inter alia*, ti japë FKCF një kredi që i korrespondon shumës maksimale prej US\$ 10,000,000 (dhjetë milionë Dollarë SH.B.A.), në përputhje me dhe sipas kushteve të asaj kontrate.
- (D) Nëpërmjet një kontrate kredie datë 20.09.2004 Fondi OPEC ka rënë dakort, *inter alia*, ti japë FKCF një kredi që i korrespondon shumës maksimale prej US\$ 8,000,000 (tetë milionë Dollarë SH.B.A.), në përputhje me dhe sipas kushteve të asaj kontrate (kontatat e kredisë nën Kushtet Paraprake A, B, C and D do të përcaktohen bashkërisht si më poshtë, "Kontratat e Kredisë").
- (E) Pengdhënësi është zotëruesi i ligjshëm i 1 200 000 (njëmilionë e dyqind mijë) kuotave të Shoqërisë, të barazvlefshme me 100% (njëqind për qind) të kuotave të emetuara nga Shoqëria (si më poshtë, "Kuotat").
- (F) Si kusht paraprak për dhënien e kredisë sipas Kontratave të Kredisë, Pengdhënësi ka rënë dakort, *inter alia*, t'i verë në dispozicion Kredidhënësve (siç përkufizohen më poshtë) një Barrë Siguruese dhe një peng mbi kuotat që Pengdhënësi zotëron në kapitalin e Shoqërisë dhe ose në filiale të tjera të saj, përfshirë Kuotat, në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të FKCF sipas Kontratave të Kredisë.
- (G) Palët (siç përkufizohen më poshtë) bien dakort se qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të bëjë të mundur që Kredidhënësit të përfitojnë të drejtën e zotërimit të Kuotave në rast mospërmbushjeje të Shoqërisë sa më lehtë dhe sa më shpejt e mundur, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ËSHTE RËNË DAKORT si më poshtë vijon:

1. INTERPRETIMI

1.1 Kushtet paraprake dhe shtojcat

Kushtet paraprake dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë pjesë themelore të saj, dhe janë të detyrueshme si për Palët, ashtu edhe për trashëgimtarët, si dhe të tretëve të cilëve mund t'u kalojnë të drejtat dhe/ose detyrimet e kësaj Marrëveshjeje.

1.2 Përkufizime

Përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë Marrëveshje, apo kur përmbajtja e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në Kontratën e Kredisë do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje. Për më tepër, termat në vijim do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

"Marrëveshje" do të thotë kjo marrëveshje, siç mund të ndryshohet dhe/ose riformulohet herë pas here.

"Ligji i Zbatueshëm" do të thotë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe e gjithë normativa kombëtare apo lokale, urdhëresë, dekret apo ligje ose rregullore të tjera të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe të zbatueshme në çdo kohë dhe herë pas here për sa kohë që kjo Marrëveshje do të zbatohet.

"Kodi Civil" do të thotë Ligji shqiptar nr. 7850, datë 29 korrik 1994, me ndryshimet përkatëse.

"Kodi i Procedurës Civile" do të thotë Ligji shqiptar nr. 8116, datë 29 mars 1996, me ndryshimet përkatëse.

"Kolateral" do të thotë Kuotat dhe të Drejtat e Lidhura me to.



"Dollar" do të thotë monedha zyrtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

"Rasti i Ekzekutimit të Detyrueshëm" do të thotë ndodhja dhe /ose vërtetimi i njerës prej rrethanave të mëposhtme:

- (i) Një rast mospërbushjeje nga ana e FKCF e ndonjë detyrimi sipas cilësdo prej Kontratave të Kredisë, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në çdonjerën prej tyre;
- (ii) Ndonje deklaratë dhe garanci e bërë nga Shoqëria apo Pengdhënësi në lidhje me këtë Marrëveshje rezultojnë e pasaktë;
- (iii) Nëse çfarëdo vendimi gjykate bëhet i ekzekutueshëm kundrejt Shoqërisë ose Pengdhënësit;
- (iv) Shoqëria ose Pengdhënësi është në falimentim ose në pamundësi pagese apo procedura falimentimi ose pamundësie pagese kanë filluar kundra Shoqërisë dhe ose Pengdhënësit, ose Shoqëria ose Pengdhënësi ka ndërmarrë procedura falimentimi të vullnetshëm.

"Ligji për Barrat Siguruese" do të thotë Ligji Shqiptar nr. 8537 më datë 18 tetor 1999, me ndryshimet përkatëse, së bashku me Urdhëresën Nr. 6278 datë 2 shkurt 2001 të Ministrisë së Financave së Republikës së Shqipërisë "Për Miratimin e Rregullores për Barrat Siguruese", me ndryshimet përkatëse.

"Kredidhënësit" do të thotë së bashku IFC, EBRD, Alpha Bank dhe Fondi OPEC.



"Barra Siguruese e Kredidhënësve" mban kuptimin që i jepet këtij termi në Nenin 2.1; *me kusht që* termi "Barra Siguruese e Kredidhënësve" përfshin çdo Barrë Siguruese tjetër që do të krijohet nën dhe në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje.

"Barrë" do të thotë çdo hipotekë, peng, barrë, privilegj, preferim, ngarkim, kalim, sekuestrim, kompensim ose garanci e çfarëdo lloji tjetër ose çdo marrëveshje apo kontratë tjetër që krijon një garanci mbi ose në lidhje me, ose çdo procedurë ndarje të depozitar të pronave ose marrëveshje preferimi në lidhje me Kolateralin.

"Kontratat e Kredisë" mban kuptimin e përmendur në Kushtin Paraprak (D) të kësaj Marrëveshjeje.

"Peng" mban kuptimin që i jepet këtij termi në Nenin 2.1; *me kusht që* termi "Peng" të përfshijë çdo peng tjetër që do të krijohet sipas ose në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

"Kuotat" mban kuptimin e përmendur në Kushtin Paraprak (E) të kësaj Marrëveshjeje.



"Regjistri i Barrëve Siguruese" mban kuptimin që i jepet në Ligjin për Barrët Siguruese.

"Të Drejtat e Lidhura" do të thotë:

- (i) çdo dividend ose interes i paguar ose i pagueshëm në lidhje me Kuotat;
- (ii) çdo kuotë, letra me vlerë, të drejta, të holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (nëse me anë të kthimit, bonus, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimit, këmbimit ose ndryshe) në lidhje me ose mbi cilëndo nga Kuotat;
- (iii) të gjithë dividendët, interesat ose të ardhura të tjera në lidhje me çdo aset të përmendur nën-paragrafin (ii) më lart; dhe
- (iv) të gjithë të drejtat e votës në lidhje me Kuotat, të cilat mund të ushtrohen si në asamblenë e zakonshme, ashtu edhe në asamblenë e jashtëzakonshme të Shoqërisë, sipas Nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje.

"Detyrimet e Garantuara" do të thotë:

- (i) të gjithë detyrimet monetare (dhe detyrimet të cilat mund të vlerësohen në të holla) dhe detyrimet e FKCF kundrejt Kredidhënësve sipas Kontratave të Kredisë, duke përfshirë, por pa rënë në kundërshtim me parashikimet e përgjithshme paraardhëse, përmbushjen e duhur të të gjithë detyrimeve për pagesat në lidhje me kryegjënë, interesat, kamat-vonesat, tarifën, kostot dhe shpenzimet, dëmet, taksat dhe taksat e pullës të pagueshme, çdo shumë për shërbime ndërmjetësimi që do të paguhet pas parapagimit ose ripagimit të të gjithë apo një pjesë të Kredisë në një datë tjetër nga data e caktuar për pagesën, dhe të gjitha e çdonjëra prej kostove, shpenzimeve, taksë pulle, taksat apo tarifën e pagueshme në lidhje me mbrojtjen, ruajtjen apo ekzekutimin e detyrueshem të të drejtave të Kredidhënësve sipas Kontratave të Kredisë; dhe,
- (ii) të gjithë detyrimet e Shoqërisë dhe të Pengdhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje.



(iii) Te gjithë detyrimet qe Pengdhenesi ka marre persiper ose do te marre persiper perkundrejt Kredithenesve, duke perfshire, per te menjanuar cdo dyshim:

- (a) Detyrimet e Pengdhenesit qe rrjedhin nga Marreveshja e Garancise nenshkruar midis Pengdhenesit dhe EBRD me 10.9.2004;
- (b) Detyrimet e Pengdhenesit qe rrjedhin nga Marreveshja e Garancise nenshkruar midis Pengdhenesit dhe IFC me 10.9.2004;
- (c) Detyrimet e Pengdhenesit qe rrjedhin nga Marreveshja e Garancise, sic percaktohet ne Seksionin 1.01 te kontrates se kredise nenshkruar midis FKCF dhe Fondit OPEC referuar ne Kushtet Paraprake (D);
- (d) Detyrimet e Pengdhenesit qe rrjedhin nga Marreveshja e Garancise nenshkruar midis Pengdhenesit dhe Alpha Bank me 21.9.2004.

"Barra Siguruese" mban kuptimin qe i jepet ne ligjin per Barrat Siguruese.

"Njoftimi i Barrës Siguruese" do të thotë njoftimi që i bëhet regjistrit për Barrët Siguruese siç jepet nga ky Regjistër i Barrëve Siguruese.


"Periudha e Garancisë" do të thotë periudha që fillon në datën e këtij akti dhe mbaron në datën në të cilën të gjithë Detyrimet e Garantuara janë shlyer dhe paguar në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme.

"Shitës" do të thotë institucioni bankar ose ndërmjetësi financiar që do të zgjidhet në përputhje me Nenin 7.2.

1.3 Interpretimi

(a) Në këtë Marrëveshje (si dhe në të gjithë dokumentët e tjerë që lidhen me këtë Marrëveshje), përveçse kur qëllimi i përdorimit është dukshëm i ndryshëm, një referencë për:

- (i) "palë" i referohet secilës prej Shoqërisë, IFC, EBRD, Alpha Bank, Fondi OPEC ose Pengdhenësi, sipas rastit;
- (ii) "akt normativ" përfshin çdo rregullore, rregull, urdhër zyrtar, kërkesë apo orientim shqiptar (që mund të ketë ose jo fuqinë e ligjit) të çdo autoriteti qeveritar, agjencie, departamenti apo institucioni rregullator, vetë-rregullues apo çdo lloj organizate apo autoriteti;
- (iii) "person" përfshin çdo individ shqiptar apo të huaj, çdo person juridik, firmë, shoqëri, ortakëri, ent shtetëror ose joint-venture, dhe përfshin trashëgimtarët dhe personat të cilëve u kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e kësaj Marrëveshjeje;
- (iv) çdo Nen, paragraf ose Shtojcë, përbën një referencë për këtë Nen, paragraf apo Shtojcë të kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur është përcaktuar shprehimisht ndryshe;
- (v) kjo Marrëveshje, ose çdo dokument tjetër, kontratë ose marrëveshje, përfshin referimet te kjo Marrëveshje ose këto dokumente, kontrata ose marrëveshje, siç mund të ndryshohen, përpunohen ose shtohen herë pas here;



5

(vi) kjo Marrëveshje i referohet kësaj Marrëveshje së bashku me Shtojcat bashkëngjitur asaj;

(vii) çdo ligj shqiptar, vendim, dekret ose akt normativ shqiptar përfshin çdo ligj, vendim, akt normativ, dekret që ndryshon ose zëvendëson ose ka ndryshuar ose zëvendësuar atë dhe përfshin çdo akt nënligjor (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo urdhër apo vendim të një ministrie apo autoriteti tjetër kompetent) të bërë në përputhje me çdonjërin prej këtyre ligjeve, vendimi, dekreti ose akti normativ;

(viii) "Palët" i referohet bashkërisht Shoqërisë, Pengdhënësit dhe secilit prej Kredithënësve.

- (b) Nëse e kërkon përmbajtja, fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe numrin shumës dhe anshjelltas, dhe fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë.
- (c) Titujt në këtë Marrëveshje përdoren vetëm me qëllim orientimi.
- (d) Në rast të një konflikti ndërmjet një dispozite të kësaj Marrëveshje dhe një Shtojce të saj, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë mbi dispozitat e asaj Shtojce.
- (e) Për t'ju përshtatur Ligjit Për Barrët Siguruese, referimet që bëhen në këtë Marrëveshje për "Pengdhënësin" përcaktojnë "Barrëdhënësin" dhe referimet për "Kredithënësit" përcaktojnë "Barrëmarrësin".


2 OBJEKTI I MARRËVESHJES

2.1 Krijimi i Pengut dhe i Barrës Siguruese të Kredithënësve

Pengdhënësi si një garanci për shlyerjen e plotë dhe të pakthyeshme të Detyrimeve të Garantuara, me anë të këtij akti (i) në mënyrë të pakthyeshme jep peng në favor të Kredithënësve, që pranojnë, Kuotat dhe të Drejtat e Lidhura me To, me përjashtim të të drejtave të votës dhe të drejtave të përfitimit të dividendit, të cilat do të rregullohen sipas parashikimeve të Nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje ("Peng"), dhe (ii) në mënyrë të pakthyeshme bie dakort për dhënie dhe krijimin e një Barre Siguruese mbi Kuotat dhe Të Drejtat e Lidhura Me To në favor të Kredithënësve ("Barra Siguruese e Kredithënësve").

2.2 Kuotat e ardhshme dhe të drejtat e lidhura me to

Pengu dhe Barra Siguruese e Kredithënësve do të mbulojë automatikisht të gjithë kuotat e ardhshme të kapitalit që Pengdhënësi mund të zotërojë herë pas here në Shoqëri duke përfshirë, por pa u kufizuar në, të gjitha dhe secilën prej kuotave të nënshkruara nga Pengdhënësi si rrjedhojë e zmadhimeve të çdo lloji të kapitalit. Në lidhje me këtë, Pengdhënësi duhet të lidhë sa më shpejt një marrëveshje pengu dhe një Barrë Siguruese thelbësisht në formën e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo document tjetër, dhe ndërmerri çdo veprim tjetër, që mund të jetë i nevojshëm ose i këshillueshëm në mënyrë që çdonjerë dhe të gjitha kuotat e ardhshme të Shoqërisë të zotëruara nga Pengdhënësi të jepen peng në favor Kredithënësve dhe që të krijohet një Barrë Siguruese mbi këto kuota dhe të drejtat e lidhura me to.



M BS P

DETYRIMET E GARANTUARA

Pengu dhe Barra Siguruese e Bankës jepen si garanci e radhës së parë për dhe deri në përmbushjen e plotë dhe të pakushtëzuar të Detyrimeve të Siguruara. As Pengu dhe as Barra Siguruese e Kredihënësve nuk do të zbriten në asnjë mënyrë për arsye të shlyerjes së pjesshme të Detyrimeve të Garantuara.

KOMPLETIMI I PENGUT

- (a) Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 3 (tre) ditësh pune duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, Pengu do të regjistrohet në regjistrin e zotëruesve të kuotave të Shoqërisë, sipas Nenit 547 të Kodit Civil, dhe një kopje e noterizuar e kësaj faqe të regjistrit të kuotave të Shoqërisë që provon këtë regjistrim do t'u jepet Kredihënësve.
- (b) Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, Shoqëria duhet të pajisë Kredihënësit me vendimin e asamblesë së zotëruesve të kuotave që autorizon krijimin e Pengut. Ky vendim depozitohet në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit të Tiranës dhe një ekstrakt zyrtar nga dosja tregtare e Shoqërisë që mbahet pranë Regjistrin Tregtar dhe provon regjistrimin e Pengut, do ti dërgohet Kredihënësve.
- (c) Pengdhënësi dhe Shoqëria me anë të këtij akti autorizojnë Kredihënësit të nënshkruajnë, kompletojnë, dërgojnë, regjistrojnë dhe depozitojnë të gjithë dokumentet e mëtejshme që Kredihënësit konsiderojnë të nevojshme ose të përshtatshme. Pengdhënësi dhe Shoqëria do të nënshkruajnë, dërgojnë, kompletojnë, regjistrojnë dhe depozitojnë të gjithë dokumentet e mëtejshme që Kredihënësit mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme për të realizuar qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, për të kompletuar dhe siguruar vazhdimësinë e Pengut, për mbrojtjen dhe ruajtjen e Kolateralit dhe ekzekutimin e të drejtave të Kredihënësve nën këtë Marrëveshje.

5 KOMPLETIMI I BARRËS SIGURUESE TË KREDIDHËNËSVE

5.1 Rregjistrimi i Barrës Siguruese të Kredihënësve

- (a) Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda tre ditësh pune nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, Barra Siguruese e Kredihënësve do të regjistrohet në Regjistrin e Barrëve Siguruese.
- (b) Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda tre Ditësh Pune duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Barra Siguruese e Kredihënësve regjistrohet në regjistrin e zotëruesve të kuotave të Shoqërisë dhe një kopje e noterizuar e faqes së regjistrit të kuotave të Shoqërisë që vërteton regjistrimin e Barrës Siguruese të Kredihënësve do t'i dërgohet Kredihënësve.
- (c) Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria duhet të japë Kredihënësve vendimin e asamblesë së ortakëve të saj që miraton krijimin e Barrës Siguruese të Kredihënësve.

Handwritten signatures and initials are present at the bottom of the page, including a large signature on the left, a signature in the center, and several initials on the right.

- (d) Pengdhënësi dhe Shoqëria me anë të kësaj Marrëveshjeje autorizojnë Kredihënësit që të regjistrojnë Njoftimet e Barrës Siguruese lidhur me Barrën Siguruese të Kredihënësve, dhe të nënshkruajnë, dërgojnë, kompletojnë, regjistrojnë dhe depozitojnë të gjithë dokumentet e tjera që Kredihënësit i konsiderojnë të nevojshme ose të përshtatshme. Pengdhënësi dhe Shoqëria nënshkruajnë, kompletojnë, regjistrojnë dhe depozitojnë të gjithë dokumentat dhe kryejnë të gjithë veprimet që Kredihënësit mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme në mënyrë që të realizojë qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, të kompletojnë dhe të sigurojnë vazhdimësinë e Barrës Siguruese të Kredihënësve, të mbrojnë dhe të ruajnë Kolateralin dhe të ekzekutojnë të drejtat e Kredihënësve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

5.2 **Forma e Regjistrimit të Pengut dhe të Barrës Siguruese të Kredihënësve në Regjistrin e Kuotave**

Forma e regjistrimit në regjistrin e kuotave të Shoqërisë të Pengut dhe të Barrës Siguruese të Kredihënësve është parashikuar në Shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje.

6 **TË DREJTAT E VOTËS DHE DIVIDENDËT**

6.1 **Të drejtat e votës**

Deri në vërtetimin e një Rasti i Ekzekutimit të Detyrueshëm, të drejtat e votës të lidhura me Kuotat, në asamblenë e zakonshme si dhe në asamblenë e jashtëzakonshme të ortakëve të Shoqërisë, ushtrohen nga Pengdhënësi, *me kusht që* këto të drejta të mos ushtrohen në asnjë rast nga Pengdhënësi në një mënyrë të tillë që do të mund të cënonte vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose e cila nuk është në përputhje me dispozitat e Kontratave të Kredisë apo çdo marrëveshje tjetër të lidhur me to.


6.2 **Dividendët**

Deri në vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm, Pengdhënësi ka të drejtë të përftojë të gjithë dividendët që rrjedhin nga Kuotat.

6.3 **Vërtetimi i një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm**

- (a) Me vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm, Kredihënësit apo secili prej tyre do t'i dërgojë një njoftim Pengdhënësit dhe Shoqërisë duke i informuar ata se është vërtetuar një Rast Ekzekutimi i Detyrueshëm dhe, gjatë kohëzgjatjes së Rastit të Ekzekutimit dhe deri sa Kredihënësit apo secili prej tyre të informojnë Pengdhënësin dhe Shoqërinë me shkrim se Rasti i Ekzekutimit ka pushuar së ekzistuari, Kredihënësit kanë të drejtë, por nuk janë të detyruar që:

- (i) të ushtrojnë të drejtat e votës që lidhen me Kuotat, në asamblenë e zakonshme dhe në asamblenë e jashtëzakonshme të ortakëve të Shoqërisë; dhe
- (ii) të përftojnë të gjithë dividendët që lidhen me Kuotat. Dividendët e përfituar në këtë mënyrë nga Kredihënësit do përdoren për shlyerjen e Detyrimeve të Garantuara të mospërmbushura deri në atë datë. Kredihënësit do të kenë titull të vecantë menjëherë të ekzekutueshëm për të përftuar në mënyrë të drejtpërdrejtë



nga Shoqëria të gjithë dividendët ose pagesa të tjera, në përputhje me Nenin 550 të Kodit Civil dhe Nenin 30 të Ligjit për Barrët Siguruese.

- (b) Në lidhje me të drejtat e Kredidhënësve sipas paragrafit (a) të këtij neni 6.3, Pengdhënësi dhe Shoqëria heqin dorë nga çdo kërkim, veprim, mbrojtje, përjashtim apo kundër padi lidhur me ushtrimin nga ana e Kredidhënësve të të drejtave të tyre ose lidhur me përmbajtjen e çdo njoftimi nga Kredidhënësit se Rasti i Ekzekutimit të Detyrueshëm është vërtetuar apo nuk ekziston më, përveçse kur një kërkim, veprim, mbrojtje, përjashtim apo kundër padi mund të bëhet nga Pengdhënësi apo Shoqëria në rastin e neglizhencës së rëndë apo sjelljes keqdashëse të Kredidhënësive dhe me qëllimin e vetëm për të kërkuar dëmshpërblimin e çfarëdolloj dëmi të shkaktuar si pasojë e kësaj neglizhence të rëndë apo sjelljeje keqdashëse; me kusht që ky kërkim, veprim, mbrojtje, përjashtim apo kundër paditë mos këtë një efekt negativ në ushtrimin nga ana e Kredidhënësve të të drejtës së tyre të parashikuar në paragrafin (a).

7 EKZEKUTIMI I PENGUT DHE/OSE I BARRËS SIGURUESE TË KREDIDHËNËSVE

7.1 Ekzekutimi nëpërmjet Shitjes ose Cedimit

- (a) Me vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm dhe në çdo kohë paskëta, secili prej Kredidhënësve ka, pa cënuar të drejtat e tjera ose rivendosjen në vend të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, ose në bazë të ligjit në fuqi, të drejtë që të deklarojë menjëherë si të kërkueshme dhe të pagueshme të gjithë detyrimin e garantuar nga kjo Marrëveshje, dhe të marrë shumën totale të borxhit së bashku me shpenzimet e arsyeshme që përfshijnë shpenzimet gjyqësore, tarifat e avokatëve dhe të gjithë shpenzimet e tjera ligjore, dhe të gjithë të drejtat dhe rivendosjen në vend të tyre të Barrëmarrësit në bazë të Ligjit për Barrët Siguruese, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar shitjen e Kuotave dhe të drejtën e shpërblimit të çdo dëmi ose humbjeje, e drejtë të cilën Kredidhënësit mund ta gëzojnë sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- (b) Në mënyrë që të përjashtohet çdo dyshim, Palët pranojnë dhe bien dakort se, me vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm, secili nga Kredidhënësit mundet që, duke zgjedhur lirisht me vullnetin e tyre të lirë, të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe rivendosjen në vend të të drejtave në përputhje me nenin 7.2, ose të drejtat dhe rivendosjen në vend të tyre të parashikuara nga Ligji për Barrët Siguruese në përputhje me kushtet e Nenit 7.3.

7.2 Ekzekutimi sipas Kodit Civil

- (a) Palët bien dakort se, me vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm, Kredidhënësit do të njoftojnë Pengdhënësin në përputhje me Nenin 556, paragrafi 1 i Kodit Civil. Nëse Pengdhënësi nuk kundërshton sipas Nenit 556, paragrafi 2 i Kodit Civil, Kredidhënësit apo secili prej tyre do të ketë të drejtën të kërkojnë shitjen e Kuotave, nëpërmjet Shitësit, në përputhje me paragrafët në vazhdim. Palët bien gjithashtu dakort se në këtë rast, Kredidhënësit do të kenë të drejtën të përcaktojnë nëse Kuotat duhet të shiten në tërësi apo pjesërisht, në një ose shumë këste, me ose pa ankand.
- (b) Shitësi zgjidhet nga Kredidhënësit nëpërmjet njoftimit me shkrim që Kredidhënësit ose secili prej tyre i dërgon Shoqërisë, Pengdhënësit dhe vetë Shitësit. Palët bien dakort se Shitësi do të drejtojë procedurën e shitjes në përputhje me rregullat dhe kushtet e

9

përcaktuara nga Kredithënësit e të parashikuara në paragrafin (a) më sipër, dhe do të përcaktojnë çmimin e Kuotave brenda 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga data në të cilën Shitësi merr njoftimin më shkrim të Kredithënësve. Në përcaktimin e çmimit të Kuotave, Shitësi mund të marrë parasysh pjesën që kuotat zenë në kapitalin e Shoqërisë, situatën financiare të Shoqërisë, fitimet e Shoqërisë dhe vlerën e aseteve të saj, pozicionin e Shoqërisë në treg dhe çfarëdolloj kushti dhe/ose rrethane që ndikon në vlerën e kuotave, më kusht që, gjithësesi, çmimi i përcaktuar nga Shitësi të jetë në çdo rast i arsyeshëm dhe i pranueshëm nga pikëpamja tregtare.

(c) Shitësi do të drejtojë procedurën e shitjes së Kuotave duke identifikuar dhe ftuar blerësit potencialë të dorëzojnë një ofertë për blerjen e Kuotave. Shitësi do të ftojë jo më pak se 5 (pesë) blerës potencialë, ndër të cilët përfshihen IFC, EBRD, Alpha Bank dhe Fondi OPEC. Ftesa e Shitësit duhet të përmbajë përshkrimin e Kuotave, çmimin e përcaktuar në përputhje me pikën (b) më sipër dhe afatin përfundimtar brenda të cilit duhen dorëzuar ofertat i cili nuk mund të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë duke filluar nga data e marrjes së ftesës.

(d) Shitësi do të vlerësojë ofertat në përputhje me kriteret e çmimit më të lartë, dhe nuk do të marrë në konsideratë ofertat në të cilat çmimi i ofruar është më i ulët se ai i përcaktuar sipas pikës (b). Shitësi duhet të kompletojë vlerësimin e ofertave brenda 45 (dyzetepesë) ditëve kalendarike duke filluar nga afati i dorëzimit të tyre, dhe fton Pengdhënësin the ofertuesin e radhës së parë të negociojë marrëveshjen për shitjen e Kuotave brenda të njëjtës periudhë. Marrëveshja për shitjen e Kuotave duhet të lidhet brenda 3 (tre) muajve duke filluar nga data e afatit të fundit për prezantimin e ofertave.


(e) Palët nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje bien dakort në mënyrë të pakthyeshme të bazohen në vendimet e Shitësit, të cilat janë përfundimtare dhe të detyrueshme për to, me përjashtim të rastit kur një ose më shume nga ata mendon me mirëbesim se përcaktimet e Shitësit janë të pasakta ose qartësisht të pandershme ose kanë qenë pasojë e një sjellje të gabuar të Shitësit. Në këtë rast, mosmarrëveshjet apo kundërshtimet zgjidhen sipas Nenit 14.2 të kësaj Marrëveshjeje.

(f) Në rast se asnjë nga ofertat nuk mund të konsiderohet sipas pikës (d), ose nëse Shitësi nuk merr asnjë ofertë që kualifikohet, ose marrëveshja për shitjen e Kuotave nuk do të lidhet brenda afateve kohore të parashikuara në paragrafin (d), Kuotat do të shiten me anë të ankandit publik, në përputhje me Nenin 556, paragrafi 2 të Kodit Civil.

7.3 Ekzekutimi i detyrueshëm sipas Ligjit për Barrët Siguruese

(a) Pengdhënësi pranon se secili nga Kredithënësit ka të drejtë që të ushtrojë të gjitha të drejtat e akorduara Barrëmarrësit sipas ligjit për Barrët Siguruese si dhe të gjitha të drejtat që lidhen me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të përcaktuara nga Ligjit për Barrët Siguruese.

(b) Në mënyrë të veçantë, me vërtetimin e një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm, Kredithënësit apo secili prej tyre ka të drejtën t'i propozojë Pengdhënësit që të marrë Kuotat apo një pjesë të tyre në mënyrë që të përmbushen të gjitha apo një pjesë e Detyrimeve të Garantuara në përputhje me nenin 37, paragrafi 1 i Ligjit për Barrët Siguruese. Në rast se Pengdhënësi jep një njoftim kundërshtues sipas përcaktimeve të nenit 37, paragrafi 2 i Ligjit për Barrët Siguruese, Kredithënësit apo secili prej tyre kanë të drejtë të kërkojnë shitjen e Kuotave në përputhje me paragrafin e mëposhtëm.



- (c) Kredidhënësit apo secili prej tyre do të njoftojnë Pengdhënësin sipas përcaktimeve të nenit 35, paragrafi 1 të Ligjit për Barrët Siguruese. Shitja e Kuotave do të jetë një ankand publik në kuptim të nenit 35, paragrafet 2 dhe 3 të Ligjit për Barrët Siguruese, dhe do të drejtohet e kryhet nga Shitësi në përputhje me nenin 7.2.

8 ZËVENDËSIMI DHE NËNRENDITJA

8.1 Heqja dorë ose drejtës së zëvendësimit të Pengdhënësit

Pengdhënësi shprehimisht dhe në mënyrë të pakthyeshme heq dorë, në favor të Kredidhënësve, nga çdo e drejtë e zëvendësimit që Pengdhënësi mund të gëzojë kundrejt Shoqërisë ose ndonjë debitori tjetër si pasojë e ekzekutimit të Pengut ose të Barrës Siguruese të Kredidhënësve. Kjo heqje dorë është e vlefshme në favor të Kredidhënësve deri në kthimin e Pengut dhe çlirimin e Barrës Siguruese të Kredidhënësve.

8.2 Pranimi i Shoqërisë dhe i Kredidhënësve

Shoqëria dhe Kredidhënësit marrin dijeni dhe pranojnë në mënyrë të pakthyeshme heqjen dorë të së drejtës së zëvendësimit nga Pengdhënësi sipas Nenit 8.1.

8.3 Nënrenditja


Me përjashtim të sa parashikohet në Nenin 8.1, Pengdhënësi bie dakort se të gjithë të drejtat ose pretendimet që mund të ketë kundrejt Shoqërisë ose ndonjë garantuesi të Shoqërisë si rrjedhojë ose në lidhje me ekzekutimin e Barrës Siguruese të Kredidhënësve, do të jetë e nënrenditur (nuk do të preferohet) të drejtave të Kredidhënësve sipas Kontratave të Kredisë.

9 DEKLARATA DHE GARANCI

9.1 Deklaratat dhe Garancitë e Pengdhënësit

Pengdhënësi i deklaron dhe garanton Kredidhënësve si vijon:

- (a) Pengdhënësi është pronari i vetëm ligjor i Kuotave dhe i të Drejtave të Lidhura me To. Nuk ekziston asnjë Barrë Siguruese apo Barrë mbi të gjithë apo pjesë të Kuotave dhe të Drejtave të Lidhura me To, në favor të të tretëve, përveç Marrëveshjes së Pengut dhe Barrës Siguruese;
- (b) Kuotat janë emetuar në mënyrë të vlefshme dhe janë nënshkruar në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar në fuqi dhe janë shlyer në tërësi. Pengdhënësi ka fuqi dhe kompetenca të plota të vendosë një peng të vlefshëm dhe efektiv dhe një Barrë Siguruese mbi Kolateralin në favor të Kredidhënësve;
- (c) Kuotat përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë dhe, në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, asnjë veprim nuk është ndërmarrë nga Shoqëria për të zmadhuar kapitalin e saj;
- (d) nuk janë paraqitur kërkesë padi apo pretendime në proces ose Pengdhënësi nuk është në dijeni për ndonjë kërkesë padi apo pretendim potencial të ngritur përpara



ndonjë gjykatë apo paneli arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, lidhur me Kolateralin;

- (e) dhënia, krijimi dhe regjistrimi i Pengut dhe Barrës Siguruese në favor të Kredidhënësve parashikohet nga objekti i Pengdhënësit dhe i Shoqërisë dhe të gjithë autorizimet e nevojshme ose të përshtatshme në lidhje me dhënien, krijimin dhe regjistrimin e Pengut dhe të Barrës Siguruese janë marrë dhe kanë fuqi dhe efekt të plotë, duke përfshirë, me qëllim shmangjen e cdo dyshimi, autorizimet që parashikohen në nenin 4, paragrafi (b) dhe neni 5 paragrafi (c);
- (f) dhënia, krijimi dhe regjistrimi i Pengut dhe Barrës Siguruese në favor të Kredidhënësve dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk bien ndesh me asnjë marrëveshje ose veprim tjetër, në të cilën Pengdhënësi ose Shoqëria mund të jenë palë ose ndonjë dispozitë ligjore, rregullore, vendim, dekret, vendim gjyqësor ose vendim autoriteti publik, ose dokument i Shoqërisë i detyrueshëm për Pengdhënësin dhe/ose Shoqërinë, dhe të gjithë detyrimet e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë detyrime të vlefshme dhe me fuqi detyruese për Pengdhënësin dhe Shoqërinë;
- (g) Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar rregullisht dhe që ushtron veprimtarinë e saj sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe nuk është subjekt i asnjë procedure falimentimi, paaftësie paguese apo procedure të ngjashme në Shqipëri apo në ndonjë juridiksion tjetër. Pengdhënësi është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (S.a.L) e themeluar rregullisht dhe që ushtron veprimtarinë e tij sipas legjislacionit të Republikës së Libanit dhe nuk është subjekt i asnjë procedure falimentimi, paaftësie paguese apo procedura të ngjashme në Liban apo në ndonjë juridiksion tjetër;
- (h) Shoqëria dhe Pengdhënësi nuk janë në gjendje paaftësie paguese dhe nuk parashikohet të jete e tille ne baze te informacionit ekzistues .

9.2 Njohja e mëtejshme dhe Përsëritja e Deklaratave dhe Garancive

Të gjitha deklaratat dhe garancitë e Pengdhënësit të parashikuara nga neni 9 do të konsiderohen se do të përsëriten cdo ditë gjatë Periudhës së Kohëzgjatjes së Garancisë në varësi të fakteve dhe rrethanave ekzistuese.

10 PREMTIME

10.1 Premtime të Pengdhënësit

Deri në momentin e përfundimit të kësaj Marrëveshjeje Pengdhënësi në përputhje me Nenin 10.3. të saj, me shpenzimet e veta, është i detyruar të:

- (a) dërgojë tek Kredidhënësit sa më shpejt dhe të kërkojë nga Shoqëria që ti dërgojë Kredidhënësve, sa më shpejt, të gjithë njoftimet dhe të gjithë dokumentet e tjera të marra në lidhje me Kolateralin, duke përfshirë, pa u kufizuar në, pretendimet apo paditë e palëve të treta;

- (b) kërkojë nga Shoqëria të krijojë, nëse nuk ekziston, regjistrin e kuotave, në të cilin duhet të rregjistrohet Pengu në përputhje me Nenin 4 dhe Nenin 547 të Kodit Civil, dhe Barra Siguruese e Kredihënësve duhet të rregjistrohet në përputhje me Nenin 5;
- (c) të kërkojë nga Shoqëria që të mbajë librat përkatës të shoqërisë dhe të bëjë të mundur që Kredihënësit të kenë të drejtë ti konsultojnë ato dhe të bëjnë kopje ose kërkojnë pjesë të këtyre librave;
- (d) të mos ndërmarrë, dhe të kërkojë nga Shoqëria që të ndërmarrë, asnjë veprim (përfshirë, pa kufizime, ushtrimin e të drejtave të votës të lidhura me Kuotat):
- (i) i cili mund të cënojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose të drejtave dhe interesave të Kredihënësve; ose
- (ii) që mund të kenë një ndikim thelbësor negativ mbi vlerën ose statusin ligjor të Kolateralit;
- (e) të ndërmarrë, dhe të kërkojë nga Shoqëria të ndërmarrë, të gjitha veprimet (duke përfshirë por pa u kufizuar në, ushtrimin e të drejtave të votës të lidhura me Kuotat) që mund të jenë të nevojshme ose të dobishme për të mbrojtur vlefshmërinë, efektivitetin dhe zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose të drejtave të Kredihënësve, gjithashtu kundër pretendimeve apo padive të palëve të treta;
- (f) të nënshkruajë dhe dorëzojë menjëherë të gjitha dokumentat si dhe të kryejë të gjitha veprimet që mund të jenë të nevojshme apo të këshillueshme me qëllim që të:
- (i) regjistrojë, kompletojë dhe mbajë Pengun me fuqi të plota dhe të regjistrojë, kompletojë dhe mbajë Barrën Siguruese të Kredihënësve me fuqi të plota;
- (ii) garantojë që secila dhe të gjitha Kuotat e ardhshme të kapitalit dhe të drejtat e lidhura me to të Shoqërisë të zotëruara nga Pengdhënësi të jepen peng në favor të Kredihënësve në përputhje me Nenin 2.2.; dhe
- (iii) të lejojë Kredihënësit të ushtrorjnë të drejtat e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, pa kufizim, të gjitha të drejtat e zbatueshme në rast vërtetimi të një Rasti Ekzekutimi të Detyrueshëm;
- (g) të mos lejojë që Shoqëria të shndërrohet në një formë tjetër, përveç rastit kur kjo miratohet me shkrim nga Kredihënësit, miratim i cili nuk duhet marrë në mënyrë të paarsyeshme;
- (h) të mos shesë ose tjetërsojë të gjithë ose pjesë të të drejtave të tij të pronësisë mbi Kolateralin;
- (i) të nënshkruajë *pro-quota* në të gjithë zmadhimet e ardhshme të Kapitalit të Shoqërisë përveç rastit kur Kredihënësit shprehimisht japin pëlqimin e tyre me

M

shkrim që një palë e tretë të nënshkruajë zmadhimin e kapitalit ose pjesë të tij, rast në të cilin Pengdhënësi do të bëjë të mundur që kjo palë e tretë të japë Peng dhe të krijojë Barrë Siguruese thelbësisht në formën e kësaj Marrëveshjeje përsa i përket Kuotave të nënshkruara nga ai;

- (j) me përjashtim të Pengut dhe të Barrës Siguruese të Kredidhënësve (dhe pengjet e Barrat Siguruese të krijuara në përputhje me Nenin 2.2), të mos krijojë ose lejojë vendosjen e një Barre në favor të një pale të tretë mbi të gjithë ose pjesë të Kolateralit;
- (k) të dëmshpërblejë secilin nga Kredidhënësit dhe të ruajë atë të pacënuar nga të gjitha pretendimet, akuzat dhe paditë të ngritura dhe/ose të paraqitura nga të tretët, të cilat lidhen me Kolateralin, Pengun dhe/ose Barrën Siguruese të Kredidhënësve; dhe
- (l) të nënshkruajë, njohë dhe dorëzojë të gjitha ato dokumente që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Kredidhënësit me qëllim që të vihet në zbatim kjo Marrëveshjeje dhe të paguajë të gjitha shpenzimet për kërkime, regjistrime dhe depozitime.

10.2 Pranimi i Shoqërisë

Shoqëria pranon detyrimet e premtimet e Pengdhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakort të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund të çenojë ose ndalojë zbatimin e tyre.

10.3 Përfundimi dhe Çlirimi

Me kryerjen e pagesave të cdo shume të papaguar të principalit dhe interesit në bazë të të gjitha Kontratave të Kredisë, Shoqëria dhe/ose Pengdhënësi mund të kërkojë, dhe Kredidhënësit do të jenë të detyruar të konfirmojnë brenda 6 (gjashtë) muajve pas marrjes së kësaj kërkesë që Detyrimet e Garantuara janë shlyer dhe paguar plotësisht. Përvec rastit kur Kredidhënësit njoftojnë Shoqërinë ose/dhe Pengdhënësin për ndonjë pretendim të pazgjidhur përfundimisht (rast në të cilin kjo Marrëveshje do të përfundojë dhe Barra Siguruese do të çlirohet pas zgjidhjes së këtij/këtyre pretendimi/prendimeve) kjo Marrëveshje do të përfundojë dhe Barra Siguruese e Kredidhënësve do të çlirohet nga Kredidhënësit me anë të një konfirmimi të tillë.

11 DËMSPËRBLIMI, TAKSAT, KOSTOT DHE SHPENZIMET

11.1 Përgjegjësia e Kredidhënësve

Pavarësisht nga Neni 40 i Ligjit mbi Barrët Siguruese dhe Neni 549 i Kodit Civil, asnjëri prej Kredidhënësve nuk do të jetë përgjegjës, përveç rasteve të neglizhencës së rëndë ose mospërbushjes së vullnetshme, për dëme të shkaktuara Pengdhënësit dhe/ose Shoqërisë gjatë ushtrimit ose kur dështon të ushtrrojë të drejtat, veprimet ose vënien në vend të të drejtave për të cilat ata kanë të drejtë në kuptim të kësaj Marrëveshjeje.



(e) Për Alpha Bank:

Alpha Bank A.E., Dega e Tiranës
Në vëmendje të: Drejtorisë së Degës
Boulevardi Zogj, no. 47
Tirana
Shqipëri
Fax: +355.4.232.102

(f) për Fondin OPEC:

OPEC Fund for International Development
Parkring, nr. 8
A-1010 Vjenë
Austri
Fax: +43.1.513.92.38

12.2 Ndryshimi i adresës

Secila palë mund t'i komunikojë të tjerëve me postë rekomande një tjetër adresë për të gjitha njoftimet.

12.3 Forma e Njoftimit

Të gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera sipas kësaj Marrëveshje apo në lidhje me të do të jepen me shkrim dhe, nëse nuk kërkohet ndryshe edhe nga legjislacioni i zbatueshëm, mund të dërgohen me faks. Çdo njoftim i tillë do të konsiderohet se është dhënë nëse faksi është marrë nga marrësi, me kusht që njoftimi i dhënë në një ditë jo-pune do të konsiderohet se është marrë ditën pasuese të punës.


13 DISPOZITA TË NDRYSHME

13.1 Ndryshime dhe Përjashtime

Asnjë ndryshim apo përjashtim nga dispozitat e kësaj Marrëveshje nuk do të ketë fuqi ligjore përveç rastit kur ai bëhet me miratimin me shkrim të Palëve. Kredidhënësit mund të miratojnë zgjatje të afateve kohore dhe lehtësira të tjera, kompromise, pajtime, falje dhe çlirim nga detyrimi ose të hyjë në marrëveshje me Shoqërinë lidhur me Kolateralin siç do të gjykohet e përshtatshme prej Kredidhënësve, pa rënë ndesh me përgjegjësinë e Shoqërisë dhe të Pengdhënësit dhe të drejtat e detyrimit e Kredidhënësve sipas kësaj Marrëveshje apo sipas legjislacionit të zbatueshëm ose ndonjë legjislacioni të zbatueshëm.

13.2 Ndryshime, Transferime, Ripërtëritje

Kjo Marrëveshje do të jetë detyruese për Pengdhënësin dhe Shoqërinë dhe trashëg imtarët e tyre respektivë, cesionarët apo komisionerët e tyre, edhe në rast të ndryshimit, transferimit apo ripërtëritjes së Kontratës së Kredisë apo kësaj Marrëveshjeje dhe si Pengdhënësi dhe Shoqëria bien dakort shprehimisht për qëllim të Nenit 556 të Kodit



11.2 Dëmshpërblimi

Pengdhënësi në bazë të kërkesës do të rimbursojë secilin prej Kredihënësve për të gjitha taksat dhe tatimet, kostot, shpenzimet dhe tarifat (përfshi tarifat ligjore dhe ato të noterëve) të përballuara nga Kredihënësit në lidhje me krijimin, regjistrimin, ruajtjen dhe ekzekutimin e Pengut dhe të Barrës Siguruese të Kredihënësve ose ekzekutimin e Kolateralit.

12 NJOFTIMET

12.1 Adresat

Të gjitha njoftimet sipas kësaj Marrëveshje apo në lidhje me të do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

(a) për EBRD:

European Bank for Reconstruction and Development
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Angli
Në vëmendje të: Operation Administration Unit
Fax: +44-20-7338-6100

(b) për IFC:

International Finance Corporation
Në vëmendje të: Director, Global Manufacturing & Services Department
2121 Pennsylvania Avenue N.W.
Washington, D.C. 20433
U.S.A.
Fax: +1.202.974.43.21

(c) për Pengdhënësin:

Seament Holding S.A.L.
Në vëmendje të: Z. Mark Bouri
Rabieh, First Avenue
Vila 48, Antelias,
Liban
Fax: 961.440.81.60

(d) për Shoqërinë:

Fushe-Kruja Cement Factory Sh.p.k.
Attention: Mr. Sadi Dahdale, General Manager
Rruga "Abdyl Frashëri", Pall. 11/1, Kati i 7.
Tirana
Albania
Fax: 00355.4.830.08.03

Civil, për vazhdimësinë e kësaj Marrëveshjeje në rast ripërtëritje të plotë apo të pjesshme të Detyrimeve të Garantuara (duke përfshirë ripërtëritjen e Kontratës së Kredisë apo pjesë të saj), dhe secili nga Pengdhënësit dhe Shoqëria merr përsipër të konfirmojë me shkrim miratimin e tij lidhur me këtë vazhdim, nëse kërkohet nga Kredihënësit, në të njëjtin moment apo para ndryshimit, transferimit apo ripërtëritjes së Kontratës së Kredisë apo para transferimit apo kalimit të Detyrimeve të Garantuara.

13.3 Transferime

As Pengdhënësi, as Shoqëria nuk mund të transferojnë apo kalojnë, tërësisht apo pjesërisht asnjë nga të drejtat e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të Kredihënësve.

13.4 Rivendosja tërësore e të drejtave

Të gjithë të drejtat, veprimet dhe përfitimet e Kredihënësve sipas kësaj Marrëveshjeje janë shtesë dhe nuk përjashtojnë asnjë të drejtë, veprim apo shpërblim tjetër mbi të cilin Kredihënësit kanë të drejta në kuptimin kontraktual (përfshirë, pa kufizime, ato të Kontratës së Kredisë) apo në ligj.

13.5 Taksat dhe Shpenzimet

Të gjithë taksat, detyrimet, shpenzimet dhe disbursimet të tjera lidhur me nënshkrimin dhe kompletimin e kësaj Marrëveshjeje që përfshijnë, por pa u kufizuar në, tarifa ligjore dhe noteriale, tarifa të regjistrimit, ose të tjera taksa të tjera që janë bërë të pagueshme, do të përballohen nga Pengdhënësi. Nëse ndonjë prej këtyre taksave, detyrimeve, shpenzimeve dhe disbursimeve të tjera do të përballohen nga Kredihënësit, Pengdhënësi do të rimbursojë ata për të gjitha këto taksa, detyrime, shpenzime dhe disbursime menjëherë pas marrjes nga Kredihënësit të kërkesës përkatëse të shoqëruar nga një dokument justifikues pagese apo çdo dokumenti tjetër që provon në mënyrë të arsyeshme pagesën e kryer nga Kredihënësit.

13.6 Marrëveshja Garantuese dhe Titulli Ekzekutiv

Shoqëria dhe Pengdhënësi pranojnë se (a) kjo Marrëveshje përbën një "Marrëveshje Garantuese" në kuptim të Nenit 2 të Ligjit për Barrat Siguruese, dhe (b) secila nga Kontratat e Kredisë dhe kjo Marrëveshje janë "titulli ekzekutiv" në kuptim të Nenit 31 të Ligjit për Barrat Siguruese dhe të Nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile.

13.7 Heqje dorë nga e drejta

Në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm, Shoqëria dhe Pengdhënësi këtu heqin dorë nga e drejta e tyre të kërkojnë sekuestrimin e Kuotave sipas Nenit 552 të Kodit Civil.

13.8 Garantimi i interesave të posaçme

Të gjithë Palët pranojnë dhe konfirmojnë shprehimisht se Pengu dhe Barra Siguruese e Kredihënësve e krijuar sipas kësaj Marrëveshjeje përbëjnë një garanci për llogari të Kredihënësve, të ndarë dhe pa lidhje me, çfarëdolloj garancie tjetër që është i dhënë apo

Handwritten signatures and initials are present at the bottom of the page, including a large signature on the left, a signature in the center, and several initials on the right.

do t'i jepet EBRD, IFC, Alpha Bank ose Fondit OPEC, nga Shoqëria ose ndonjë nga ortakët e Shoqërisë për të siguruar përmbushjen e Detyrimeve të Garantuara. Palët këtu bien dakort se Kredihënësit kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga kjo Marrëveshje pavarësisht nga të drejtat e tyre që rrjedhin nga ndonjë garanci tjetër për shlyerjen e Detyrimeve të Garantuara.

13.9 Ndarja

Dispozitat e secilit prej Neneve dhe paragrafeve të kësaj Marrëveshjeje janë të zbatueshme pavarësisht njëra-tjetra dhe vlefshmëria e tyre nuk çenohet nëse cilado nga të tjerat është e pavlefshme. Nëse njëra nga dispozitat është nul por do të ishte e vlefshme nëse pjesë e saj do të ishte fshirë, dispozita në fjalë zbatohet me ato ndryshime që mund të jenë të nevojshme për ta bërë atë të vlefshme.

13.10 Kredihënës si kreditorë të veçantë dhe të përbashkët

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe të Ligjit të Zbatueshëm, Kredihënësit duhet të konsiderohen si kreditorë të veçantë dhe të përbashkët të Pengdhënësit dhe Shoqërisë. Rrjedhimisht, secila prej EBRD, IFC, Alpha Bank dhe Fondi OPEC do të kenë të drejtën të gëzojnë dhe ushtrojnë të drejtat e Kredihënësve në kuptim të kësaj Marrëveshjeje, si edhe të çdo të drejte tjetër që i takon në bazë të Ligjit të Zbatueshëm, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në Kodin Civil dhe Ligjin mbi Barrët Siguruese.

13.11. Gjuha e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në 16 (gjashtëmbëdhjetë) kopje, 8 (tetë) prej të cilave janë në Anglisht dhe 8 (tetë) në shqip. Në rast mospërputhje midis versionit Anglisht dhe versionit Shqip, mbizotëron versioni Anglisht.

14. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURISDIKSIONI


14.1 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

14.2 Arbitrazhi dhe Juridiksioni

Kjo Marrëveshje apo çdo e drejtë e Kredihënësve që rrjedh vetëm apo lidhet me këtë Marrëveshje, mundet sipas zgjedhjes së Kredihënësve, të ekzekutohet nga secili prej tyre në gjykatat e Shqipërisë, apo në çdo gjykatë tjetër që ka juridiksionin, por një zgjedhje e tillë nuk do të ndalojë Kredihënësit që të zgjedhin arbitrazhin sipas termave të parashikuara në Kontratat e Kredisë, në rast se ekzekutimi është i pamundur në praktikë dhe i parrealizueshëm sipas Ligjit të Zbatueshëm. Për përfitimin e Kredihënësve, Shoqëria me anë të kësaj Marrëveshjeje pranon në mënyrë të pakthyeshme juridiksionin jo ekskluziv të gjykatave të Shqipërisë, në lidhje me mosmarrëveshjet apo pretendimet që rrjedhin apo që lidhen me këtë Marrëveshjeje apo me ndonjë shkelje, përfundim apo pavlefshmëri që rrjedh apo që lidhet me këtë Marrëveshjeje.

Asgjë në këtë Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si kufizim i të drejtës së Kredihënësve për të filluar procedurat ligjore kundër Shoqërisë në mënyrën e autorizuar nga ligji i juridiksionit përkatës. Fillimi prej Kredihënësve ose secilit prej tyre të ndonjë procedure





ligjore në një apo disa juridiksione nuk do t'i heqë të drejtën Kredihënësve për të filluar ndonjë procedurë ligjore në ndonjë juridiksion tjetër, konkurrues ose jo. Shoqëria në mënyrë të paravokueshme heq dorë nga çdo kundërshtim që ka tani apo mund të ketë në të ardhmen në lidhje me vendin e procedimit, si dhe nga çdo kundërshtim që ka tani apo mund të ketë në të ardhmen në lidhje me paraqitjen e tyre në organin jo të duhur.

14.3

Privilegjet dhe Imunitetet e EBRD dhe IFC dhe Fondi OPEC

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk kuptohet si heqje dorë, mohim ose ndryshim i imuniteteve, privilegjeve ose përjashtimeve të EBRD, IFC ose Fondit OPEC, të dhëna nga Marrëveshja e Krijimit të European Bank of Reconstruction and Development, Aktit të Themelimit të International Finance Corporation, Marrëveshja për Krijimin e Fondit OPEC for International Development, Marrëveshja për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Investimeve midis Fondit OPEC dhe Shqipërisë, marrëveshje ndërkombëtare ose ligji i zbatueshëm.



Handwritten signatures and initials, including a large signature on the left, a signature with a horizontal line underneath, and several other signatures and initials on the right.

Unë, Noteri, pasi i lexova me zë të lartë palëve këtë Kontratë, të përgatitur në 8 (tetë) kopje në gjuhën shqipe dhe 8 (tetë) kopje në anglisht jam bindur se palët e gjejnë Kontratën në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe unë vërtetoj se nënshkruan kontratën në përputhje me ligjin.

FUSHE-KRUJA CEMENT FACTORY SH.P.K.

Nga: Z. Sadi Dahdale

Përfaqësues të Autorizuar
SADI DAHDALU

SEAMENT HOLDING S.A.L.

Nga: Z. Jacques Sehnaoui

Jacques J. Sehnaoui
Përfaqësues i Autorizuar

INTERNATIONAL FINANCE CORPORATION

Nga: Znj. Elira Sakiqi

Elira Sakiqi
Përfaqësuese e Autorizuar

EUROPEAN BANK FOR RECONSTRUCTION
AND DEVELOPMENT

Nga: Z. Murat Yildiran

Murat Yildiran
Përfaqësues i autorizuar



ALPHA BANK A.E. DEGA TIRANË

Nga: Z. Andreas Galatoulas

Andreas Galatoulas
Z. Orfea Dhuci
Përfaqësues të Autorizuar

PULLE TAKSE



OPEC FUND FOR INTERNATIONAL DEVELOPMENT

Nga: Znj. Klotilda Ferhati

Klotilda Ferhati
Përfaqësuese e Autorizuar
Notere

Përkthyes

Monika Pupe
Monika Pupe



Mirzoza Sadushi
Mirzoza Sadushi

REPUBLIKA SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr. Rep. Dt. 20/4/05
VERTETIM

Vërtetohet se fatura është e
njërta me origjinalin Dokumenti
U Paragj. Nr. Pasap
Y Malo
NOTER AGIM RËBO

SHTOJCA A


Forma e regjistrimit në rregjistrin e ortakëve të Shoqërisë

Pranohet se nëpërmjet një marrëveshjeje për pengun dhe barrën siguroese mbi pjesët e kapitalit të shoqërisë më datë 26.01.2005 ("Marrëveshja"), Seament Holding S.a.L., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe që ekziston në bazë të ligjeve të Republikës së Libanit, me seli në Rabieh, First Avenue, Vila 48, Antelias, Liban, zotëruese e 1 200 000 (njemilione e dyqind mijë) kuota të Shoqërisë, që përbëjnë 100% e kapitalit të Shoqërisë, ka vënë peng këto kuota në favor të:

- a) International Finance Corporation, një organizatë ndërkombëtare me seli në 2121 Pennsylvania Avenue N.W., Washington, D.C 20433, U.S.A.;
- b) European Bank for Reconstruction and Development, një organizatë ndërkombëtare me seli në One Exchange Square, London EC2A 2JN, England;
- c) Alpha Bank A.E., Dega Tiranë, një degë banke, e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Boulevardi Zog 1, no. 47, Tirana, Albania;
- d) Opec Fund for International Development, një organizatë ndërkombëtare me seli në Parkring no. 8 A-1010, Vienna, Austria.

Është pranuar se, nëpërmjet Marrëveshjes, Seament Holding ka gjithashtu krijuar një barrë siguroese mbi kuotat e mësipërme në favor të International Finance Corporation, European Bank, Alpha Bank dhe Opec Fund for International Development, siç është përshkruar më lart.

Këto kuota janë vënë peng dhe janë objekt i barrës siguroese të marrë përsipër nga Shoqëria, në kuptim të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshje. Të drejtat e votës dhe të drejtat mbi dividendët rregullohen nga Neni 6 i Marrëveshjes, një kopje e së cilës është depozituar në Shoqëri.



The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials. On the left, there is a signature that appears to be 'JH'. In the center, there is a large, stylized signature. To the right of this, there is another signature that looks like 'OB'. Below these, there are several smaller initials and marks, including a 'u' and a 'B'.